



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7967 /2023
Data: 19.09.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tetë -VIII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.08.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.
3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.
4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.
5. Plotësim ndryshimi i vendimit me numër 01/Nr.4957/2023 për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin

Sherif Berisha thekson:- në emër të Lëvizjes Vetëvendosje kërkoj që të shtohet edhe një pikë e rendit të punës, propozim për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej njëqind euro duke u bazuar në ligjin që është miratuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka propozimin që të shtohet edhe një pikë e rendit të punës hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.
3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.
4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.
5. Plotësim ndryshimi i vendimit me numër 01/Nr.4957/2023 për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Propozim për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej njëqind euro.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për , 1 abstenim.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-përveç materialit të cilin e kemi përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:-kërkoj sqarime më shumë për çështjen e ujit për shkak se dihet që kohët e fundit kemi probleme me çështje të ujit.

Mehmet Ballazhi thekson:- përmes mjeteve të informimit jam munduar me sqaruar çështjen e ujit sepse çështja e ujit është problem i ka hershëm, fabrika e ujit është ndërtuar në vitin 2010 dhe ka funksionuar dy muaj dhe tash e kemi futur në funksion por problem ka qenë se kush po e menaxhon që asnjë mekanizëm nuk kemi mundur me shtijë në funksion përveç kompanisë “Bifurkacioni” dhe e mira krejt kësaj është që kemi arritur me bërë pranimin teknik dhe me marr në menaxhim kompania “Bifurkacioni” . Vitin e kaluar i kemi ndarë tridhjetë mijë euro për vendosjen e orëmatësve në mënyrë që me shtyrë procesin përpara dhe sipas informacioneve që kam janë afër njëqind ujëmatës që duhet të vendosen. Fabrika është funksionalizuar dhe uji pastrohet dhe është i nivelit më të mirë të mundshëm që mundet me u pastruar në krahasim me gjitha fabrikat të cilat e bëjnë shitjen e ujit . Dje i kam pasur tre ekspertë hidrologë një nga Maqedonia dhe dy nga Prizreni të cilët i kanë katër fabrika të ujit në menaxhim, i kanë marr disa informacione dhe konstatime dhe kanë potencuar që për momentin ka 14 litra në sekondë që përpunohet dhe me kalkulimet e tyre janë 350 litra për kokë banori dhe potencojnë që janë mbi kërkesat e nevojshme për qytetarin, mirëpo problemi është i mos futjes në menaxhim të ujë, orëmatësve dhe kyçjet ilegale. Hidrologët do ta bëjnë një raport detal për çështje të ujit.

Refet Kalisi thekson:- është mirë që të angazhohemi të gjithë për këtë çështje dhe nëse është e nevojshme me ndarë mjete financiare për këtë çështje. Mirë është me i lënë disa projekte mos me i realizuar por me u fokusuar në zgjidhjen e problemit të ujit. Uji keqpërdoret dhe deri sa nuk vendosen orëmatësit uji keqpërdoret dhe duhet që kompanisë “Bifurkacioni” me i bërë presion që me i shtirë proceset përpara. Sa do të kemi mundësi që me i realizuar projektet e hartuara sepse e dimë që buxhetin e kemi të limituar.

Mehmet Ballazhi thekson:- për çështjen e ujit vullneti është i gjithëve dhe në legjislacionin e fundit kam qenë opozitë dhe ju kam bashkangjitur iniciativës që me ja kushtuar një mandat për çështjen e zgjidhjes së ujit por të njëjtin mendim besoj që edhe ju e ndani. Në fillim të mandatin kur kemi ardhur qëllimin e kemi pasur me hartuar projekte në mënyrë që t'i kemi të gatshme duke u bazuar me buxhet tonin, përmes kërkesave të cilat i bëjmë nëpër Ministri të ndryshme , OJQ-të dhe qeverive të ndryshme.

Hatmije Kalisi thekson:- cila ka qenë arsyeja e takimit të Kryetarit të Komunës me Kryetarin e Qelanos në Itali.

Mehmet Ballazhi thekson:-kjo është në vazhden e bashkëpunimit me komunën e Qelanos që ka ndodhur në vizitën e ish Kryetarit të Komunës në Qelano që e ka krijuar një bashkëpunim dhe në kuadër të asaj kemi pas ftesë prej komunës së Qelanos që është me kërkesën e qytetarëve tonë të cilët jetojnë dhe veprojnë atje për me vazhduar bashkëpunimin dhe jemi të interesuar me vazhduar këtë bashkëpunim në kuadër të arsimit dhe kulturës. Kam zhvilluar edhe takime me qytetarët të cilët jetojnë atje dhe kërkesë e tyre ka qenë për me i lehtësuar procedurat për me u pajisur me dokumente në komunë dhe gjatë sezonës së mërgimtarëve e kemi shtuar orarin e punës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- së bashku me shkresën i kemi përcjell edhe propozimet për ndryshimin e rregullores. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- në Han të Elezit i kemi dy gurëthyes që operojnë dhe gurëthyesi "Preni" nuk ka punë dhe është mirë me ja ulur taksën për shkak se nuk janë të barabartë me gurthyesin Alba.

Resul Suma thekson:- a ka pas ndonjë arsye propozimi për ngritjen e taksës për te çerdhja.

Majlinda Kaloshi thekson:-rregullorja për taksa është e bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe nuk e precizon që biznesi duhet me u ngarkuar me taksë sipas numrit të punëtorëve apo fitimit por ngarkohet si taksë sipas kategorisë që i përket.

Hisni Luri thekson:- arsyeshmëria e ngritjes së taksës është që me ju ofruar fëmijëve shërbime më cilësorë.

Sherif Berisha thekson:- cilat OJQ janë të liruar prej taksës.

Arsim Dernjani thekson:- të liruar janë OJQ të ndryshme që rast konkret kemi te panairi që OJQ-ja e ka ndihmuar komunë me vendosje të çadrave që fermerët me i ekspozuar prodhimet e tyre.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:-në shkresë janë paraqitur të gjitha detajet se çka ka me u zëvendësuar te plani i transparencës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR SHQYRTIMIN E AKTIT PËR VENDIMIN ME NUMËR 01/5269/2023

5. Plotësim ndryshimi i vendimit me numër 01/Nr.4957/2023 për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:-në material i keni të shënuar në detale rialokimin e mjeteve se në cilat kategori do të bëhen.

Refet Kalisi thekson:- çka do të investohet në rregullimin e infrastrukturës nëpër shkolla sepse është investuar nëpër shkolla.

Hisni Luri thekson:- do të rregullohet muri mbrojtës te shkolla fillore në fshatin Seçishtë dhe rregullimi i sallës që është përpara. Do të rregullohet te çerdhja një mbulojë për drutë për shkak se janë shumë afër dhe do të rregullohen edhe disa kërkesa të cilat i kanë drejtorët e shkollave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.4957/2023 PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE KAPITALE

6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:-në materialin e informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023 janë të paraqitur në detaje të gjitha të dhënat.

Ajnure Thaçi thekson:- krahasimi që është bërë me një tabelë kemi një numër rreth 157 nxënës më pak , a keni ndonjë plan për mësimdhënësit të cilët dalin në pension të ciklit klasorë mos me pranuar staf tjetër për shkak se na dalin tepriçë nëse nuk kemi nxënës mjaftueshëm.

Sherif Berisha thekson:- për vitin i cili ka kaluar çfarë lloje të trajnimeve për mësimdhënës ka pasur dhe a ka pasur rezultate .

Hisni Luri thekson:- kemi rekomandim prej Ministrisë së Arsimit se nëse shkon tu rënë numri i mësimdhënësve të mos rekrutojmë mësimdhënës të tjerë por mendoj që jemi ende herët për këtë çështje për shkak se Ministria i ka ndryshuar kriteret. Trajnimet të cilat i kemi prej Ministrisë për kurikulën e kemi bërë një listë për mësimdhënësit që duhet t'i ndjekin këto trajnime por nuk janë ftuar për shkak numrit të vogël që e kemi pasur por përsëri kemi bërë listë për mësimdhënësit që duhet t'i ndjekin trajnimet. Trajnimin që e kanë vijuar është Eshkollori dhe besoj që mësimdhënësit do ta marrin seriozisht Eshkollorin dhe janë të gatshëm se kanë filluar me i futë të dhënat nëpër sistem. Ka pasur edhe trajnime të tjera por ndikimin nuk mundemi me vërejtur tash por më vonë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7.Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:-përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:-a do t'i subvenciononi në vjeshtë fermerët.

Resul Suma thekson:- a mundet komuna me ju ndihmuar bujqve që në çdo tri apo katër vite secilin fshat me subvencionuar me nga një auto kombaj për shkak se shumica e autokombajëve janë nga pjesa e fshatit Krivenik dhe bujqit e fshatit Paldenicë dhe Dimcë po kanë probleme për shkak të vonesave në korrje shirje.

Abduraman Bushi thekson:- edhe në KPF kam potencuar se kam në plan me përkrahur grurin po a do ta përkrahim në vjeshtë apo në korrje do ta shikojmë për shkak se te mbjellja në vjeshtë e grurit ka pasur raste që në disa komuna kanë ndarë farë për mbjellje dhe ka pasur raste që nuk e kanë mbjell. Disa komuna e kanë subvencionuar korrjen sepse dihet saktë se sa sipërfaqe janë mbjell. Çështja e autokombajit është çështje private dhe si komunë nuk kemi mundësi.

Refet Kalisi thekson:- kërkoj që të ngritët shuma për ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8.Propozim për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej njëqind euro.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-kërkoj pesë minuta pauzë me shefat e grupeve parlamentare për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:-pas konsultave me shefat e grupeve parlamentare hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-sa përqind deri në këto momente është inkasuar tatimi në pronë

Lindita Ballazhi thekson:-për momentin nuk e kam shumë e saktë por në ndërkohë mundem me ua përgatitur. Nëse hynë në fuqi Ligji shumë e mjeteve financiare që e humbim vetëm për prona është mbi 85,000.00 €, ndërsa për parcela ende nuk kemi ndonjë raport final prej departamentit në pronë.

Sherif Berisha thekson:- kërkesa ime ishte që të ju falen 100 € por sa do që e kanë banorët për vitin 2023 tatimin me ju falë. U diskutua me shefat e grupeve parlamentare që Ligji është proceduar për në gjykatë kushtetuese por nuk kemi ndonjë vendim për këtë çështje dhe kërkoj mbështetjen që të përkrahet ky propozim.

Refet Kalisi thekson:-unë jam për me i falë por pasi lënda është dërguar në Gjykatë Kushtetuese është mirë me pritë vendimin e gjykatës dhe pastaj mund ta mbajmë një seancë të jashtëzakonshme për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- kur bisedojmë për politika lokale bisedojmë bashkë edhe si anëtarë të kuvendit , si ekzekutiv. Ligjin e kanë dërguar në Gjykatë Kushtetuese dhe çka ndodhë nëse ne e miratojmë në kuvend dhe Gjykata Kushtetuese vendosë mas të përkohshme mund të kemi problem se nuk jemi konsistentë në përgjegjësit që i kemi sepse duhet të marrim vendim për me tërhequr për shkak se nuk mundemi me ekzekutuar. Nëse deri me datë pesëmbëdhjetë shtatorë Gjykata nuk merr vendim ne mund të thërrasim seancë të kuvendit dhe me u a falë borxhet sipas Legjislacionit në fuqi. Përpjekjet e asociacionit të komunave është që këto borxhe që i ka propozuar Qeveria për me i falë është që me ju rimbursuar komunave se në komunën tonë është problem i vogël shuma prej 85 000.00 € por janë disa komuna që shuma është deri në tre milion euro, shtatë apo tetë milionë komuna e Prishtinës . Jemi për me i falur por mënyrën dhe formën duhet ta gjejmë bashkë dhe duhet ta presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe pastaj me vepruar.

Sherif Berisha thekson:-unë kërkoj që propozimi të votohet dhe nëse merret vendim për pezullim mund të mbajmë seancë dhe ta pezullojmë vendimin .

Mehmet Ballazhi thekson:-vullneti është i gjithë secilit për me i mbështetur qytetarët duke ju falë borxhe por problemi është i procedurave ligjore që duhet të presim vendimin prej Gjykatës Kushtetuese.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 2 për 9 kundër 3 abstenim . Nuk kalon propozim për faljen e borxheve për tatim në pronë.

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:-te parku janë do hapësira si bunkerë dhe janë duke u bërë punë të këqija është mirë me i mbyllur dyert. Është bërë njoftimi që shkolle në Han të Elezit fillon me katër shtatorë cila është arsyeja që fillon në këtë datë. Te aplikimi për libra ka shumë probleme sepse prindërit nuk janë tu aplikuar për libra dhe një pjesë nuk do t'i blejnë librat për shkak se kushtojnë.

Erblin Meliqi thekson:-kam disa kërkesa nga banorët e lagjes Meliq duke ditur që buxheti miratohet në muajin shtatorë dhe kërkoj që të hyjnë si projekte në buxhetin e vitit 2024. Propozoj që në projekt buxhet për vitin 2024 të hynë rregullimi i një fushe të futbollit. Propozoj që të shtrohet rruga me kupëza betoni te varrezat e lagjes Meliq me një gjatësi prej tridhjetë metra. Propozoj që të vendosen tri pasqyra rrugore te Lagja Meliq. Banorët e Lagjes Meliq kanë prona në vendin e quajtur Kollomoqe, kërkojnë që të bëhet rregullimi i përroit edhe pse e dimë që komuna nuk mundet me buxhetin që e ka me realizuar por është mirë që ta harton një projekt dhe ta adreson në ministrit e linjës të cilat janë përgjegjëse.

Ajnure Thaçi thekson:-drejtorja e arsimit ka premtuar që do të bëjë pajisjen me tabela të mençura, a do të filloni në këtë vit apo në vitet e ardhshme.

Sherif Berisha thekson:- i nderuar kryetarë kam vërejtje duke filluar prej nënkryetarit të komunës dhe drejtorët për sjelljet e tyre në mbledhje të KPF-së dhe përgjigjet të cilat nuk i kanë dhënë.

Nexhmedin Daci thekson:- çështjen e bunkerëve te parku e kemi biseduar me Kryetarin e Komunës dhe do të mbyllet me hekura. Propozimet për projektet kapitale kërkoj që të parashtrihen në mbledhjen e radhës.

Hisni Luri thekson:-njoftimin të cilin e keni parë vlen vetëm për shkollën fillore “Ilaz Thaçi” që do të fillon me katër shtatorë për arsye se jemi në realizimin e implementimit të një projekti me Bashkimin Evropianë . Kemi menduar që me u kryer punimet deri dje dhe mësimi me filluar me një shtatorë por komisioni për monitorimin e projektit nuk ja ka pranuar punimet kompanisë dhe ka filluar që nga fillimi me i rregulluar shkallët. Në të gjitha shkollat e tjera është bërë dezinfektimi dhe jemi gati. Çështja e librave është problem dhe e kam adresuar te Ministria e Arsimit. Jemi munduar që me librat e vjetra me i pajisur fëmijët e lagjes Bardhi të cilët nuk kanë qasje për me u rimbursuar nga Ministria. Sa i përket tabelave të mençura kemi planifikuar për me i blerë por prej Ministrisë së Arsimit e kemi një grand që është donacion edhe prej shteteve të tjera që shuma është tetëmbëdhjetë milionë dhe kanë potencuar që mos me shpenzuar mjete për pajisje teknologjike dhe najë kanë dërguar katalogjet dhe i kemi dorëzuar, është në tri faza që kanë me u furnizuar shkollat me këto pajisje teknologjike.

Mehmet Ballazhi thekson:- është kodi i mirësjelljes që përdoret nëpër institucione dhe jashtë institucionit është Ligji për fyerje nënçmim, sulm dhe të tjera. Është ligji i cili e përcakton dhe unë nuk kam vërejtje që dikush e ka thyer kodin e mirësjelljes por është natyra e tyre se si japin përgjigjet. Çështjen e përgjigjieve mund ta diskutojmë nëse është vonuar afati.

Arsim Dernjani thekson:-për pasqyrat rrugore projekt kemi në vitin 2024 dhe besoj që do të vendosen.

Kryesuesi thekson:- a është rregulluar tabela e njoftimeve. Në QKMF kamerat janë vendosur por kush i kontrollon ato kamera.

Nora Xhoni thekson:- te vendosen dy shporta të mbeturinave në rrugën që shkon ka Jona market dhe ka lagjja e Re. Te shtëpia e z.Nexhmedin Fida të vendoset një mbrojtës në rrugë për shkak se është rrezik. A do të vazhdohet me shujtat për nxënës dhe nëse vazhdohet duhet të diskutohet me përfaqësuesit e Ministrisë për kualitetin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- u diskutuar që ka rënë numri i nxënësve dhe është mirë me dhënë një sqarim. A ekziston mundësi që me u rritur numri i punëtorëve te zjarrëfiksat që me pasur edhe në ndërrim të tretë.

Refet Kalisi thekson:- duhet të rregullohet ndriçimi ka Lagjja e Ujit të Thartë sepse disa drita nuk janë funksionale. Çështja e ujitjes së parkut ka dështuar sepse parku është bërë mirë dhe në të ardhmen me i shikuar mundësit për me bërë zgjidhje për ujitje.

Hyrijete Isufi thekson:-është mirë me rregulluar ujitjen por prej fillimit duhet me menduar këtë çështje edhe për parqet e tjera të cilat janë tu rregulluar. Kamerat duhet të jenë funksionale te parku dhe me i dënuar ata persona të cilat i dëmtojnë.

Natyrja Kalisi thekson:- pas diskutimeve që kemi pasur në Komitet për Politikë e Financa i kam shkruar imell, janë përgjigjur që për një kohë të shkurtë do të vijnë dhe i kanë bërë instalimet e nevojshme por është përsëri i njëjti problem dhe kanë premtuar që do të i qëndrojnë mbrapa deri sa të rregullohet.

Kryesuesi thekson:- është vërejtje e qytetarëve edhe pse e di që ke menduar për më mirë por tabelën e njoftimeve nuk është dashur me hequr duhet të jetë tabela e thjesht që qytetarët me u njoftuar.

Natyra Kalisi thekson:- e kemi ndryshuar tabelën te qendra për shërbim të qytetarëve dhe të gjitha njoftimet publikohen.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- kamerat në QKMF janë funksionale dhe qasjen drejt për drejt e ka drejtori i QKMF-së.

Kryesuesi thekson:-ka informacione që kamerat kontrollohen edhe prej telefonave që mendoj që është e ndaluar është mirë me pasur kujdes.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:-nuk besoj që mundet dikush tjetër me pasur kontakte për shkak se me kompaninë e cila i ka vendosur kamerat isha prezent.

Mehmet Ballazhi thekson:-numri i punëtorëve të zjarrfiksave nuk varet prej neve. Sa i përket ujitjes së parkut e kemi vendosë në Lumin Lepenc një pompë por nuk është e mjaftueshme dhe jemi tu munduar së paku drunjët me i ujitur.

Hisni Luri thekson:- derisa do të kemi mjete do të vazhdojmë me shujtat për nxënës dhe përzgjedhjen e ka bërë Ministria e Arsimit dhe nuk varet prej neve por kam kërkuar që me i sjell në dit të ndryshme por pse nuk i hajne është problem tjetër. Numri i nxënësve në rënie është në trend jo vetëm në Han të Elezit porveç komunës së Fushë Kosovës dhe Ferizajt që kanë rritje të numrit të nxënësve në komunat e tjera ka rënie për arsye të ndryshme.

Arsim Dernjani thekson:- për vendosjen e shportave do të mundohemi me i vendosur. Për çështje të ndriçimit publik në këtë vit është pak problem në këtë vit por do të mundohemi me i rregulluar.


Mehmet Ballazhi thekson:- punimet për muri mbrojtës te shtëpia e z.Nexhmedin Fida do të fillojnë të hënën.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:12.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

